



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 301 Prot.

Tiranë, më 15.03.2023

VENDIM

Nr. 12, datë 15/03/2023

MBI

“MIRATIMIN NË FAZË TË DYTË TË DOKUMENTACIONIT PËR PËRFITIMIN E BURSIVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE PËR STUDENTËT E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE (BACHELOR) PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023 NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë” (i ndryshuar), në Urdhrin e Rektorit të Universitetit të Arteve nr. 80, datë 01.11.2022, nr.1687 Prot, për “Fillimin e procedurës së pranimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit, nga ana e fakulteteve të Universitetit të Arteve, për studentët të cilët do të aplikojnë për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, për vitin akademik 2022-2023 në UART, shkresës nr. 69 prot., datë 26.01.2023 të FM dhe 1687/2 prot., datë 26.01.2023 të UART, shkresës nr. 76 prot., datë 27.01.2023 të FM dhe nr. 1687/2 prot., datë 30.01.2023 të UART, shkresës nr. 19 prot., datë 26.01.2023 të FAS dhe nr. 1687/3 prot. të UART, datë 26.01.2023 si dhe bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga çdo student aplikues në përmbushje të kriterëve të përcaktuara për përfitim dhe sipas akteve të dala për këtë qëllim, Bordi i Administrimit, pas shqyrtimit dhe diskutimit,

V E N D O S I:

1. Miratimin në fazë të dytë për përfitimin e bursës nga fondi i mbështetjes studentore për studentët aplikues renditur në *Shtojcën nr. 1* bashkëlidhur këtij vendimi që ndjekin studimet në ciklin e parë të studimeve Bachelor pranë Fakultetit të Muzikës dhe Fakultetit të Artit Skenik në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2022-2023.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

2. Ky vendim të përcillet pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL).
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Fakulteti i Muzikës dhe Fakulteti i Artit Skenik të Universitetit të Arteve si dhe Drejtoria Ekonomike.
4. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Lavdrim SAHITAJ

(Kryetar)

Jeton SHEHU

(Anëtar)

Ergis SEFA

(Anëtar)

Prof. Besnik Bisha

(Anëtar)

Prof.Asoc.Dr. Sokol SARAÇI

(Anëtar)

Lorenc VANGJELI

(Anëtar)

Vladimir LLAKAJ

(Anëtar)

